

KONVENTA KOMBËTARE E INTEGRIMIT EUROPIAN

Grupi i Punës III – Bujqësia dhe Siguria Ushqimore

Sesioni 1: “Siguria ushqimore dhe standardet e kërkuara në kuadër të integrimit europian”

9 dhjetor 2020

Zhvillime dhe Rekomandime

Legjislacioni shqiptar – miratimi dhe zbatimi i tij

- Miratimi i legjislacionit shqiptar në harmonizim me atë të BE, është vlerësuar që ka ecur mirë por problematika kryesore është mënyra sesi ky legjislacion zbatohet në vend.
- Një problem në lidhje me ligjin kryesor të sigurisë ushqimore në Shqipëri i cili harmonizohet me Rregulloren e Higjienës së BE, konsiderohet fakti që Shqipëria nuk ka një autoritet të vetëm përgjegjës për kontrollin e sigurisë ushqimore. Ky kontroll në Shqipëri kryhet nga tre autoritete të cilat janë sa të pavarura aq dhe të ndërlidhura me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë përgjegjësitë dhe procesi ndahet dhe copëtohet duke e bërë më të vështirë, më të ngadaltë dhe jo mirë të koordinuar. Kështu që një sugjerim është dhe krijimi i një autoriteti të vetëm për të mundësuar kontrollin.
- Në lidhje me parimin e dytë të rregullores së higjienës që lidhet me analizën e riskut, Shqipëria paraqet probleme pasi edhe sot ende nuk ka një plan analitik të sigurisë ushqimore.
- U rekomandua si me rëndësi hartimi i një ligji gjithëpërfshirës që të lidhë mes tyre hallkat e ndryshme të sigurisë ushqimore: bujqësia, blegtoaria, peshkimi, industria ushqimore, mjedisi, tregjet agro-blegtorale dhe mikrofinanca. Me rëndësi vlerësohet mbështetja financiare e këtyre hallkave, fuqizimi i agrobizneseve dhe rregullimi i procedurave të gjurmueshmërisë.
- Informaliteti u theksua si problematikë madhore e bizneseve bujqësore, ku nga 354 mijë fermerë vetëm 15% e tyre kanë NIPT. Për këtë ligji ‘Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor’ i pa-amenduar asnjëherë vlerësohet si i pazbatueshëm dhe sugjerohet zëvendësimi i tij më një ligj tjetër të zbatueshëm dhe të përditësuar. Përsa i përket informalitetit shifrat realisht tregojnë që ai pengon të gjitha hallkat e tjera të zinxhirit dhe të sigurisë ushqimore

- Të hartohet nga Ministria një program pune specifik për përmirësimin e situatës së sigurisë ushqimore në sektorin e blegtorisë dhe atë të akuakulturës. Me synim hapjen e eksportit të kafshëve të gjalla dhe atë të midhjeve brenda vitit 2021.
- Tregjet agro-blegtorale, u cilësuan nga GP III si hallka më e dobët ku nga 33 tregje blegtoriale, vetëm 2 i plotësojnë kriteret. Më shumë punë duhet bërë që këto tregje të arrijnë standardet e kërkuara, e kjo realizohet duke shtuar investimet dhe mbështetjen financiare dhe strukturore ndaj tyre.
- U vlerësua si pozitiv përditësimi i Kodit Penal në 2019, ku janë shtuar tre vepra të reja penale lidhur me çështjen e sigurisë ushqimore. Por u vlerësua si e rëndësishme ofrimi i rekomandimeve gjatë fazës së konsultimit publik nga aktorët e interesuar dhe të përfshirë në sigurinë ushqimore, lidhur me Kodin e ri Penal me qëllim që siguria ushqimore dhe cilësia e jetës të jenë të përfshira si duhet në këtë Kod të ri.
- Lidhur me vakumin ligjor, u tha se kemi një ligj për patentat dhe markat i cili flet ndër të tjera dhe për certifikimet, i cili i referohet dhe produkteve bujqësore. Në këtë ligj ka një rregullim nga momenti i aplikimit për regjistrim të treguesit gjeografikë apo përcaktimit të origjinë dhe më tej, por nuk ka asnjë kuadër ligjor që tregon se si shkohet deri në këtë pjesë.

Vlerësim i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore

- Kontrolli dhe legjislacioni në lidhje me kontrollin e sigurisë ushqimore nuk duhet të jetë thjesht përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë, pasi ajo ka dhe inspektimin veterinar dhe AKU dhe ka autoritetin ti urdhëroj. Pra ajo dhe është përgjegjëse për prodhimin dhe kontrollon e cila është konfliktuale dhe e gabuar.
- Siguria ushqimore lidhet dhe me parimin e lëvizjes së lirë të mallrave, ku Shqipëria ka miratuar marrëveshjen e tregtisë së lirë, ku produktet me origjinë shtazore mund të tregtohen lirshëm në BE që në 1992. Megjithatë Shqipëria tregon vetëm disa produkte të certifikuara në nivel industrie, ndërsa produktet me origjinë shtazore nuk nxirren jashtë Shqipërisë. Për këtë arsye është i nevojshëm një kontroll i vetëm autoritar veterinar, ngjashëm me atë që është sot në BE. Vetëm në këtë mënyrë prodhimet me origjinë shtazore shqiptare mund të arrijnë të gjitha kriteret dhe të lëvizin lirshëm në tregun europian.
- U shfaq si problematikë mungesa e laboratorëve të akredituar duke kërkuar që investimi në këto laboratorë të bëhet jo vetëm për infrastrukturën por dhe kapacitetet njerëzore dhe ekspertët e tyre. Vetëm në këtë mënyrë do të bëhet i mundur që të respektohen të gjitha hallkat dhe produktet shqiptare të kenë mundësi të certifikohen dhe të ekspertojnë në BE.

- Të studiohet e analizohet situata e laboratorëve në sektorin publik dhe atë privat dhe të propozohen masa për të mundësuar akreditimin e te paktën një laboratorit që ti njihen të vlefshme analizat në vendet e BE.
- Në lidhje me marrëdhënien e AKU, ai për definicion kryesor është autoriteti kombëtar për kontrollin zyrtar të sigurisë ushqimore. Sot në ligjin për ushqimin dhe inspektimin, kemi autoritetin kombëtar të ushqimit si autoriteti kombëtar që mund të inspektojë në bazë të rregullave të caktuara. Po një nga parimet që nuk përfshihet është fakti: që kur zbulohet një mangësi nuk i vihet gjobë subjektit, por i jepet kohë 3 muaj për të rregulluar masat që të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara. Një element tjetër që përbën problem është dhe fakti se inspektori varet drejtpërdrejt nga drejtori i tij, ku në BE, inspektori është i pavarur.
- Një pikë me rëndësi që u diskutua ishte dhe buxhetimi. Duke buxhetuar në mënyrë të saktë dhe bazuar në rekomandimet e ekspertëve dhe grupeve të interesit mund të bëhet e mundur që institucionet të funksionojnë dhe të kemi dhe ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Informimi dhe përfshirja e aktorëve të shoqërisë civile dhe biznesit

- Kapitulli 12 me fokus Sigurinë Ushqimore edhe pse i vlerësuar nga folësit dhe pjesëmarrës si një fushë me shumë interes dhe rëndësi, nuk ka qenë në fokus të diskutimeve dhe takimeve publike, për konsultim dhe informim në këtë fushë si nga ana e aktorëve shtetëror por edhe nga aktorë të shoqërisë civile, ekspertë të fushës apo përfaqësues nga komuniteti i biznesit. Për këtë arsye u rekomandua që më shumë takime dhe diskutime informuese e konsultuese duhet të zhvillohen në këtë çështje.
- Qëllimi kryesor i këtyre takimeve duhet të jetë si: a) informues dhe ndërjegjësuës ashtu edhe b) konsultues dhe këshillues mes aktorëve të ndryshëm dhe nevojave e problematikave që ata përballen në zbatimin e legjislacionit dhe arritjen e kriterëve.
- Rol me rëndësi u sugjerua që duhet të luajnë jo vetëm aktorët e pushtetit ekzekutiv si Ministria e Bujqësisë apo agjencitë ligjzbatuese dhe monitoruese, po një rol me proaktiv duhet të ketë dhe Parlamenti i Shqipërisë.
- Duhet të rritet bashkëpunimi dhe roli i aktorëve të shoqërisë civile si në informimin dhe monitorimin e procesit të anëtarësimit dhe negociatave të Shqipërisë ashtu dhe me fokus tema dhe artikuj specifik siç është dhe siguria ushqimore. Kjo gjë po realizohet në sajë të Këshillit Kombëtar të Integritit Europian si një autoritet konsultativ i Kuvendit dhe ku ka në përbërje të tij shumë organizata të shoqërisë civile dhe të biznesit. Por ky Këshill dhe këto organizata duhet të luajnë rol më aktiv në realizimin e aktiviteteve dhe takimeve me fokus tema të tilla specifike por shumë të rëndësishme.

- Organizatat dhe ekspertët u ftuan të përfshihen gjithashtu dhe në konsultimet publike si dhe të ofrojnë kontributet e tyre dhe në platformën online të konsultimeve publike.
- Marrja e mendimeve të grupeve të interesit dhe të organizatave të shoqërisë civile në procesin ligjvënës dhe të kontrollit parlamentar në fushën e sigurisë ushqimore u cilësua thelbësor, pasi kështu mundësohen dije të specializuara në fushën e sigurisë ushqimore, që nuk posedohen nga kuvendi dhe stafi i tij.